

[Data 21.05.2025]

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: **“BLERJE PAJISJE DHE ORENDI” E NDARË NË LOTE:**

LOTI I PARË: “PAJISJE PËR ZYRAT”

**LOTI I DYTË: “BLERJE PAJISJE DHE ORENDI PËR NEVOJA TË INSTITUCIONEVE
TË BASHKISË TIRANË”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Mobilime të ndryshme 39290000-1; Artikuj mobilimi 39516000-2

1. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **46,482,958 (dyzet e gjashtë million e katërqind e tetëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tetë) leke pa TVSH**, i ndarë në lote si më poshtë:
Loti 1: “Pajisje për zyra”, me fond limit/vlera e pritshme e kontratës: 15,408,601 (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e tetë mijë e gjashtëqind e një) lekë pa tvsh.

Loti i dytë - “Blerje pajisje dhe orëndi për nevoja të institucioneve të Bashkisë Tiranë” me fond limit/vlera e pritshme e kontratës: : 31,074,357 (tridhjetë e një milion e shtatëdhjetë e katër mijë e treqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh.

2. Burimi i financimit: Vënë në dispozicion me anë të V.K.B-së Nr. 131 dt 18.12.2024 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2025” me objekt: **“Blerje pajisje dhe orëndi”**.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT; LOTI 1 - “PAJISJE PËR ZYRAT”

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti

kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.1.1 Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe shtojcës 9 të DST-së.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku **vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.** Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Për operatorët e huaj, në rastet kur në vendin e origjinës nuk lëshohen dokumentet e kërkuara për të vërtetuar bilancet/pasqyrat financiare apo xhiron vjetore, mund të paraqesin një deklaratë për konfirmin e tyre.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/a, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

.... dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose loti, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;”. Kjo procedurë është është mbi kufirin e lartë monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e

detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse vlera e xhiros minimale për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare është jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet. Në çdo rast, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2 Kopje të certifikuara të balanceve të tre viteve të fundit 2022, 2023, 2024, të konfirmuara me vulë pranë administratës tatimore. Operatorët Ekonomikë të cilët plotësojnë 2 nga 3 kërkesat e germës "c" të nenit 41 të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" të ndryshuar; krahas balanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur (Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar) për bilancet e këtyre viteve të konfirmuara nga administrata tatimore.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të tarifave dhe taksave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 5, pika c në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitetet sipas të dhënave të QKB – së për vitin 2024 (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin e lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilin është regjistruar në QKB).

Argumentimi: Kjo kërkesë është bazuar në nenin 76 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", në përputhje me përcaktimet e ligjit Nr. 9 632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar sipas të cilit operatorët ekonomikë duhet të shlyejnë detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në çdo adresë ku ushtrorjnë aktivitetet, në Ligjin Nr. 9 920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore", i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, neni 40, në ligjin Nr. 131/2015 "Për QKB" i ndryshuar si dhe në Ligjin Nr. 9 723, datë 03.05.2007 "Për QKR", i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontratat të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i çertifikuar si kompani sipas standardeve ndërkombëtare dhe të paraqesë:

Standartin ISO 9001:2015 (ose e përditësuar), për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Standartin ISO 45001: 2018 (ose e përditësuar), Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë) objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose

organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Standartin ISO 14001:2015 ose ekuivalente ose Leje Mjedisore, „Per Sistemin e Menaxhimit te Mjedisit“ (e vlefshme); objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar). Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Kërkesa për ISO 9001 është një kërkesë e domosdoshme për të realizuar suksesin e kontratës.

ISO 45001 është standard ndërkombëtarë, i cili parashtrohet kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i shërbimit objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

AK Vlerëson të nevojshëm certifikimin e subjekteve ofertues me ISO 14001 ose ekuivalent, me qëllim garantimin se operatori ekonomik gëzon konfirmimet e nevojshme nga organizmi i vlerësimit të konformitetit, se ka ndërmarrë masa proaktive me qëllim minimizimin e ndikimit negativ në mjedis, si dhe zbaton kuadrin rregullator përkatës në fuqi për mbrojtjen e mjedisit. Kjo qasje proaktive ndaj

menaxhimit mjedisor mund të rezultojë në përfitime të prekshme, të tilla si reduktimi i mbetjeve, ruajtjes së energjisë dhe kursimeve të kostos.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues kur është i **profilit prodhues duhet të ketë të punësuar minimalisht 15 (pesëmbëdhjet) punonjës, kur është i profilit tregetues (kur është tregetues i mbi 50 % te listes se artikujve te kerkuar) jo me pak se 10 (dhjete) punonjes** të cilët duhet të figurojnë në listpagesën e shoqërisë të **paktën 1 (nje) muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.**

Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr. 9 (**Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit**). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, sipas parashikimeve të pikës 6, të nenit 26, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

Argumentimi: Kërkesa është hartuar në përputhje me pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar), Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 5/b “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose”.

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur, duke marrë në konsideratë proceset, veprimtaritë apo shërbimet që përfshihen për realizimin e kontratës bazuar në analizën e kryer për kërkesën për punonjës të specializuar/të kualifikuar.

Numri i personave të stafit të kërkuar është në përpjestim me natyrën, përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe limitet kohore të parashikuara për të përfunduar këtë procedurë.

2.3.4. Operatori ekonomik sipas natyres se tij **prodhues apo tregetues** (operator prodhues konsiderohen ato operator qe nepermjet procesit te prodhimit transfromojne lendet e para dhe ndihmese ne produkte te gatshme apo montojne pjese te produktit te prodhuara nga subjekte te tjere duke i transformuar ne produkte te gatshem. Operator tregetues jane ato operator qe marrin pjese ne blerje-shitje te produkteve te gatshme pa marre pjese ne prodhim) **duhet te kete minimalisht te punesuar punonjes sipas profesioneve me kode respektive apo te**

peraferta sipas listes se profesioneve miratuar me VKM nr. 514, date 20.9.2017 “Per miratimin e listes kombetare te profesioneve (LKP), te rishikuar”:

1 (nje) inxhinier druri (shoqerite prodhuese) vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës;
- diplomën, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm.

1 (nje) arkitekt (shoqerite prodhuese dhe tregetuese) vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës;
- diplomën, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm

2 (dy) marangoz/ mobilier/ montues mobiljesh/ përpunues druri vërtetuar me (shoqerite prodhuese dhe tregetuese):

- kontratën individuale të punës;
- diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit ne profesionin respektiv, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;

1 (nje) shofer (shoqerite prodhuese dhe tregetuese) vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës ose me kontraktim.
- leje drejtimi, e vlefshme;

3 (tre) punonjës të thjeshtë (shoqerite prodhuese dhe tregetuese) për veprimtari ndihmëse gjatë procesve të punës vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës;

Shenim: Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/b/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar; Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; Vendimi 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP) të rishikuar” dhe Urdhërit nr.99, datë 25.05.2021 “Për miratimin e katalogut kombëtar të kualifikimeve profesionale”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Punonjësit me specialitet e sipërpërmendura kërkohen në përputhje të plotë me objektin e prokurimit, duke qënë se një pjesë e madhe e artikujve të kërkuara janë mobilje druri ose materiale të tjera MDF, melaminë etj. si dhe kombinime te tyre me konstruksione metalike qe kerkojne saldim, etj, të cilat do

të prodhohen/montohen/saldohen/asemblohen e te tjere procese pune sipas përmasave dhe specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti. Ngjyra e mobiljeve është një element që nuk është përfshirë në specifikimet teknike, pasi kjo do të përcaktohet nga Autoritet Kontraktore përfituese në momentin e realizimit, e cila do të jetë në varësi të preferencave të këtyre autoriteteve me qëllim përshtatjen e mobiljeve me amjentet ku do të vendosen. Argumentimi për stafin e kualifikuar të kërkuar për realizimin e objektit të prokurimit si më poshtë:

1 (nje) inxhinier druri. (per kompanite prodhuese)

- Sigurimi i cilësisë, qëndrueshmërisë dhe plotësimi i standarteve të produkteve: Një inxhinier druri ka aftësitë dhe njohuritë për të analizuar, përzgjedhur dhe trajtuar materialet e drurit, për të siguruar që mobiljet janë të qëndrueshme dhe rezistente në kohë. Ai mund të sigurojë që lëndët e para të përmbushin specifikimet teknike dhe që produkti përfundimtar të jetë i cilësisë së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor. Mobiljet kanë të specifikuar disa standarte, dhe një inxhinier druri ka njohuritë e duhura për t'i zbatuar këto standarte gjatë procesit të prodhimit të tyre. Ai është i kualifikuar për të ndihmuar në përzgjedhjen e konstruksioneve të përshtatshme që sigurojnë stabilitetin, estetikën dhe qëndrueshmërinë e produkteve. Një inxhinier druri mund të mbykqyrë aspekte të sigurisë për produktet përfundimtare, që ato nuk paraqesin rrezik për përdoruesit e tyre. Rëndësia e kërkesës për staf të kualifikuar, për një inxhinier druri, qëndron në garantimin e cilësisë dhe përputhshmërisë së produkteve me specifikimet teknike, për të reduktuar kostot dhe për të ofruar siguri dhe qëndrueshmëri në përdorimin e produkteve nga Autoritet Kontraktore përfituese në këtë procedurë prokurimi.

1 (nje) arkitekt. (shoqerite prodhuese dhe tregetuese)

- Sigurimi i cilësisë, qëndrueshmërisë dhe plotësimi i standarteve të produkteve: Një arkitekti ka aftësitë dhe njohuritë për të analizuar, përzgjedhur dhe trajtuar materialet e artikullit të kërkuar për tu prodhuar ose blere, për të siguruar që mobiljet janë në përputhje me kërkesat materiale, dimensionet, ngjyrat dhe format e kërkuara nga porositesit. Ai mund të sigurojë që lëndët e para të përmbushin specifikimet teknike dhe që produkti përfundimtar të jetë i cilësisë së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Mobiljet kanë të specifikuar disa standarte, dhe një arkitekt ka njohuritë e duhura për t'i zbatuar këto standarte gjatë procesit të prodhimit të tyre. Ai është i kualifikuar për të ndihmuar në përzgjedhjen e konstruksioneve të përshtatshme që sigurojnë stabilitetin, estetikën dhe qëndrueshmërinë e produkteve. Një inxhinier me formim arkitekt mund të mbi dhe kqyrë aspekte të sigurisë për produktet përfundimtare, që ato nuk paraqesin rrezik për përdoruesit e tyre. Rëndësia e kërkesës për staf të kualifikuar, për një inxhinier druri dhe arkitekt, qëndron në garantimin e cilësisë dhe përputhshmërisë së produkteve me specifikimet teknike, për të reduktuar kostot dhe për të ofruar siguri dhe qëndrueshmëri në përdorimin e produkteve nga Autoritet Kontraktore përfituese në këtë procedurë prokurimi.

2 (dy) marangoz/ mobilier/ montues mobiljesh/ përpunues druri: (shoqerite prodhuese dhe tregëtuese)

Dy marangoz/ mobilier/ montues mobiljesh/ përpunues druri ka njohuritë e duhura në lidhje me përpuniminin edhe montimin e saktë të pjesëve të mobiljeve. Ai është i aftë të zbatojë me saktësi udhëzimet teknike dhe të sigurojë që çdo pjesë e montuar të jetë në përputhje me specifikimet e kërkuara. Ky specialist ndikon në shmangjen e gabimeve që ndikojnë në cilësinë dhe jetëgjatësinë e mobiljeve, duke ulur riskun e defekteve dhe problemeve gjatë përdorimit. Cilësia, stabiliteti dhe siguria janë thelbësore për mobiljet që përdoren në ambiente publike, pasi montimi i gabuar i tyre mund të rrezikojë punonjësit që do t'i përdorin ato. Gjithashtu siguron që montimi/ asemblimi apo procese të tjera të punës të kryhen në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

Ne cdo rast numri i prefesionisteve është kalkuluar mbi bazën e oreve të punës ditore, javore të punonjësit, oreve javore të punës, llojshmerise dhe numrit të artikujve që duhen kontraktuar, proceseve të punës sipas teknologjise së prodhimit të mobiljeve, vlerës totale të procedurës (fondit limit) si dhe natyrës së ofertuesit.

Ky numër punonjësish është minimale që operatori ekonomik ofertues, jo vetëm prodhues por edhe tregëtues, duhet të kenë për zbatimin e kontratës. Kjo krijon bindjen e Autoritetit kontraktor se operatori ekonomik duke patur një staf të kualifikuar, garanton produkte përfundimtare cilësor, të qëndrueshme dhe jetëgjatë, të punuara në përputhje të plotë me specifikimet teknike dhe me standartet e kërkuara në dokumentet e tenderit.

Këto mallra, në pjesën më të madhe të tyre nuk gjenden lirisht në treg me përmasat dhe specifikimet që kërkohen nga Autoritetet Kontraktore, pra kjo kontratë ka si procese prodhimit ose porositjen, e cila bëhet sipas Specifikimeve Teknike tek një prodhues, montimin ose asamblimin e mobiljeve, transportin dhe vendosjen e tyre në ambientet e Autoriteteve Kontraktore përfituese.

Punonjësit e tjerë si shoferi dhe punonjësit e thjeshtë janë të domosdoshëm për transportin dhe punën ndihmëse që do të kryhet përgjatë të gjithë proceseve të zbatimit të kontratës. Duke qënë se mjetet e transportit mund të jenë edhe me qera, përveçse në pronësi, është gjykuar e arsyeshme që shofertët mund të diponohen edhe me kontraktim.

2.3.5. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar të paktën 1 (një) punonjes të disponojë çertifikatë si "Përgjegjes për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", e cila të jetë e leshuar nga shoqëria të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të dorëzojë:

Kontratë pune e vlefshme

Certifikatën perkatese.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë një person i cili kujdeset për sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve të angazhuar për realizimin e objektit të prokurimit në respektim të Ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Per sigurinë dhe shëndetin në punë".

2.3.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për transportin e mallrave objekt prokurimit duhet të disponojë, mjetet e mëposhtme:

Mjete	Sasia	Gjendja
Mjet transporti me kapacitet mbajtes min 1.5 ton	1 copë	Pronësi ose me qera

a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme) dhe certifikata e pronësisë së mjetit.

b) Për mjetet e siguruara me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe certifikata e pronësisë së mjetit duhet të shoqërohet me kontraten perkatese të qerave.

Shënim: Kriteri 2.3.6 do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE kualifikohet në vend të parë, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe të nenit 41, të pika 5/ç të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Nëpërmjet këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomik të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund ti vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Është kërkuar që kapaciteti mbajtës të jetë minimumi 1.5 ton, duke marrë parasysh llojin e mallrave që do të transportohen, peshën dhe përmasat që kanë, sidomos disa prej mobiljeve. Një mjet me kapacitet të tillë siguron që mallrat të transportohen të sigurt dhe pa dëmtime në vendndodhjet e kërkuara.

2.3.7. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogët/ fragmente të katalogut ose skedat teknike për artikujt e listës së kërkuar që perkojnë me numrat 2,6,8,12,14. Këto dokumente duhet të përmbajë karakteristikat teknike të specifikimeve teknike të kërkuar në dokumentet e tenderit, me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të kërkuara.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve/skedës teknike nga prodhuesi është një kërkesë e domosdoshme pasi i jep mundësinë Autoritetit kontraktor verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të kërkuara.

Kërkesa për katalogun /skedës teknike ka disa avantazhe: Besueshmëria e informacionit: Një dokument teknik garanton që informacioni të jetë i saktë dhe i përditësuar. Përputhshmëria me specifikimet teknike: Siguron që produktet e ofruara përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e prokurimit. Parandalimi i mashtrimeve: Redukton rrezikun e mashtrimeve ose të ofrimit të produkteve të falsifikuara.

Për sa më sipër AK krijon siguri dhe garanci se mallrat me të cilët do të furnizohet janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DST. Ky katalog do të shërbejë gjithashtu edhe në procesin e marrjes në dorëzim të pajisjes objekt prokurimi nga Autoritetet Kontraktore përfituese për të kryer krahasueshmërinë e specifikimeve teknike gjatë marrjes në dorëzim të tij.

2.3.8. Operatori ekonomik/Bashkimi i operatoreve ekonomike sipas artikujve që marrin persiper për furnizim, për artikujt e kërkuar si më poshtë duhet të paraqesë dokumentacion të akredituar si **“Certifikate/Certifikate Testimi/Raport testimi”** për produktet:

Karrige statike pa krahe mbeshtetes (Karrige), produkt i certifikuar në përputhje me standardin SSH EN 1335-1:2020+A1:2022 (SSH EN 1335-1:2021) Mobilje zyre - Karrige pune për zyrë - Pjesa 1: Dimensionet - Përcaktimi i dimensioneve, ose e njëvlefshme dhe e përditësuar, SSH EN 1335-2:2018 (Mobilje për zyrë - Karrige për zyrë - Pjesa 2: Kërkesat e sigurisë) ose e njëvlefshme dhe e përditësuar

- **Tavoline pune e thjeshtë (tavoline pune/zyre)**, produkt i certifikuar në përputhje me standardin SSH EN 527-1:2011 Mobilje zyrash - Tavolinat e punës dhe tryezat - Pjesa 1: Përmasat, ose e njëvlefshme dhe e përditësuar SSH EN 527-2:2016 + A1:2019 Mobilje për zyrë - Tavolina pune - Pjesa 2: Kërkesat e sigurisë, fortësisë dhe qëndrueshmërisë ose e njëvlefshme dhe e përditësuar

- **Sirtariere e levizeshme me rrota (Komedine/Sirtariere)**, produkt i certifikuar në përputhje me standardin SSH EN 15338:2007 + A1:2010 (15338:2024) Aksesore metalik për mobilje – Rezistenca dhe qëndrueshmëria e mekanizmave zgjatues (shinat) dhe komponentëve të tyre, ose e njëvlefshme dhe e përditësuar.

Si dokument alternativ në vend të “Certifikate/Certifikate testimi/Raport testimi” të produkteve koresponduese të standardeve të mesiperme, operatori ekonomik mund të paraqesë Certifikata me reference standarde të mesiperme ose ekuivalente (Certifikata ekuivalente konsiderohet certifikate që nuk i referohet sistemit evropian EN të standardeve, por një sistemi tjetër standardesh por që trajton të njëjtet tregues dhe norma të testuara dhe konfirmuara të produktit si në sistemin EN)/te

”Perditesuara” sipas standarteve SSH/EN mbi konformitetin e standarteve europiane dhe te leshuara nga Organizma te Vleresimit te Konformitetit te akredituara per leshimin e ketyre dokumentave ne Republiken e Shqiperise ose Organizma Nderkombetare akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise, si dhe dokumenta te tjere alternative si ”Certifikate/Deklarate Konformiteti”, ”Deklarate CE” ”Skeda Teknike”, ”Pasaporta Teknologjike” me kusht qe keta dokumenta alternative te jene te shoqeruara me ”Certifikatat e testimit/Raportet e Testimit” per secilin produkt me reference standardet e kerkuara si me siper.

Certifikatat e kerkuara duhet te jene te vlefshme ne periudhes se realizimit te procedures se prokurimit. Certifikatat e mesiperme duhet te jene origjinale ose te njehsuara me origjinalin (kopje e noterizuar). Ne rastet kur oferta dorezohet nga nje BOE, operatoret duhet te disponojne dokumentacionin e kerkuar ne perputhje me raportin e pjesemarrjes ne furnizim, te percaktuara ne akt marreveshje.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 79 të LPP, të pikës 1, nenit 44, të VKM–së nr.285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Keto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

Bazuar në natyrën e objektit të prokurimit i cili ka punime dhe mobilim të ambjenteve është parë e arsyeshme kërkesa si më sipër për garantimin e cilësisë së punimeve dhe mallrave objekt prokurimi si dhe bazuar në Ligjin Nr.9870, datë 04.02.2008 Per standartizimin ku qëllimi kryesor i vendosjes së këtij kriteri është të rrisë nivelin e sigurisë së produkteve dhe proceseve, në mbrojtje të shëndetit e jetës së personave, si dhe mjedisin, duke ndihmuar në zbatimin e legjislacionit, në funksion të kërkesave për ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, sigurisë e shëndetit, mbrojtjes së mjedisit dhe konsumatorit, duke siguruar, në këtë mënyrë, rregulla të përbashkëta për të siguruar përdorimin me efektivitet të punës, të materialeve dhe të energjisë.

2.3.9. Operatori ekonomik duhet te deklaroje sipas tabelës 1 nese eshte prodhues ose sipas tabelës 2 nese eshte **tregtues i autorizuar** nga prodhuesi ose **distributor i autorizuar nga prodhues** per mallrat objekt prokurimi.

Tabela 1. Forma e deklarimit per operatorin ekonomik qe paraqitet si prodhues/perpunues i mallit.

Nr.	Emertimi i produktit	Vendi i origjines se mallit
1		
2		
Etj.,		

Tabela 2. Forma e deklarimit per operatorin ekonomik qe paraqitet si tregtues i autorizuar nga prodhuesi ose distributor i autorizuar nga prodhuesi/perpunuesi.

Nr.	Emertimi i produktit	Vendi i origjines se mallit	Prodhuesi/ Distributori i autorizuar nga prodhuesi/perpunuesi
1			
2			
Etj.,			

Per mallrat objekt prokurimi qe perfshihen ne tabelen 2, OE duhet te paraqese "Autorizim Prodhuesi/Autorizim Distributori/Kontrate furnizimi ose cdo dokument tjeter qe konfirmon lidhjen me furnizuesin apo posedimin e tyre". Dokumentei duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon/fax email, website, kjo e nevojshme per AK ne rast verifikimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar per njohjen origjines se produkteve pasi mbi origjinen e tyre gjykohet nese furnizuesi per realizimin e artikujve qe do te ofroje jep garancite e kerkuara ne kriteret te vecanta te kualifikimit si ne rastin e prodhuesit, por edhe ne rastin e furnizuesit te natyres tregetare, Autoriteti kontraktor ka mundesi qe te verifikojte te dhenat dhe kapacitetin furnizues, cilesor etj te kompanive furnizuese te operatorit ekonomik ofertues te natyres tregetuese.

2.3.10. Operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate me ane te se ciles merr persiper te kryeje sherbimin e transportit, montimit si dhe vendosjen neper vende te te gjitha artikujve ne adresat e percaktuara ne planin e shperndarjes. Per ngjyrat e mobiljeve, duhet te kontaktohet paraprakisht Autoriteti Kontraktor.

2.3.11. Operatori ekonomik duhet të lëshojë një deklaratë për periudhën minimale 1 (nje) vjecare të garancisë së mallrave objekt prokurimi nga data e dorëzimit të mallit, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin e defekteve për shkak të prodhimit dhe montimit.

2.3.12. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës deklaron se artikujt objekt prokurimi do të jenë të reja, të papërdorura më parë dhe pa dëmtime estetike apo në strukturë.

2.3.13. Operatori ekonomik duhet të **paraqesë një deklaratë miratimi, me anë të së cilës deklaron se artikujt per te cilet eshte kerkuar ne specifikime teknike plotesimi i standardeve te vecanta i plotesojne ato dhe merr persiper dorezimin e tyre para lidhjes se kontrates nese shpallet fitues.**

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë disponibilitet të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës sipas kërkesave të AK. Deklaratat e mësipërme janë kërkuar pasi janë të nevojshme për zbatimin e kontratës me sukses dhe për të siguruar cilësinë e

mallrave pasi mund të gjendemi para faktit që këto mallra të jenë të një cilësie të dobët ose të kenë defekte fabrikimi, ndaj OE duhet të jetë i gatshëm për zëvendësimin e tyre dhe i shërben AK për njohjen e reputacionit dhe besueshmërisë së OE.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT; LOTI 2 - “BLERJE PAJISJE DHE ORENDI PËR NEVOJA TË INSTITUCIONEVE TË BASHKISË TIRANË”

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. **Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit**, sipas Shtojcës 9;
- b. **Sigurimin e Ofertës**, sipas Shtojcës 4

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe shtojcës 9 të DST-së.*

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku **vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë **arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor**.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/a, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

.... dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose loti, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;”. Kjo procedurë është është mbi kufirin e lartë monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse vlera e xhiros minimale për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare është jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet. Në çdo rast, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” , i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të tarifave dhe taksave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 5, pika c në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitetet sipas të dhënave të QKB – së për vitin 2024 (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin e lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilin është regjistruar në QKB).

Argumentimi: Kjo kërkesë është bazuar në nenin 76 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në përputhje me përcaktimet e ligjit Nr. 9 632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar sipas të cilit operatorët ekonomikë duhet të shlyejnë detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në çdo adresë ku ushtrojnë aktivitetet, në Ligjin Nr. 9 920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, neni 40, në ligjin Nr. 131/2015 “Për QKB” i ndryshuar si dhe në Ligjin Nr. 9 723, datë 03.05.2007 “Për QKR”, i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i çertifikuar si kompani sipas standardeve ndërkombetare dhe të paraqesë:

- a) **ISO 9001:2015** ose ekuivalente, “Per Sistemin e Menaxhimit te Cilesise” (e vlefshme);
- b) **ISO 14001:2015** ose ekuivalente ose Leje Mjedisore, Per Sistemin e Menaxhimit te Mjedisit” (e vlefshme);
- c) **ISO 45001:2018/ ISO 45001-2023** (të përditësuar)ose ekuivalente, “Per Sistemin e Menaxhimit te Shendetit dhe Sigurise ne Pune” (e vlefshme);

Qellimi i certifikimit te kompanise duhet te jete sipas fushes se objektit qe do te prokurohet.

Certifikatat te jene leshuara nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise.

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, sipas nenit 88 te VKM-285 date 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certifikata ISO sipas zerave te puneve/mallrave/sherbimeve qe do te marr persiper te realizoj sipas akt-marreveshjes paraprake.

Argumentimi: Ky kriter u vendos ne perputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" i ndryshuar, si dhe nenit 44, te VKM-se Nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik"(i ndryshuar). Autoriteti/enti kontraktor, per te vertetuar se punet, mallrat ose sherbimet, objekt prokurimi, i plotesojne kerkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Kërkesa për ISO 9001 është një kërkesë e domosdoshme për të realizuar suksesin e kontratës.

ISO 45001 është standard ndërkombëtar, i cili parashtrohet kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i shërbimit objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

AK Vlerëson të nevojshëm certifikimin e subjekteve ofertues me ISO 14001 ose ekuivalent, me qëllim garantimin se operatori ekonomik gëzon konfirmimet e nevojshme nga organizmi i vlerësimit të konformitetit, se ka ndërmarrë masa proaktive me qëllim minimizimin e ndikimit negativ në mjedis, si dhe zbaton kuadrin rregullator përkatës në fuqi për mbrojtjen e mjedisit. Kjo qasje proaktive ndaj menaxhimit mjedisor mund të rezultojë në përfitime të prekshme, të tilla si reduktimi i mbetjeve, ruajtjes së energjisë dhe kursimeve të kostos.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues kur është i **profilit prodhues duhet të ketë të punësuar minimalisht 25 (njet e pese) punonjës, kur është i profilit tregetues (kur është tregetues i mbi 50 % te numenklatures se artikujve te kerkuar) jo me pak se 15 punonjes** të cilët duhet të figurojnë në listpagesën e shoqërisë të **paktën 1(nje) muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.**

Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.9 (Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, sipas parashikimeve të pikës 6, të nenit 26, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

Argumentimi: Kërkesa është hartuar në përputhje me pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar), Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 5/b “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose”.

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur, duke marrë në konsideratë proceset, veprimtaritë apo shërbimet që përfshihen për realizimin e kontratës bazuar në analizën e kryer për kërkesën për punonjës të specializuar/të kualifikuar.

Numri i personave të stafit të kërkuar është në përpjestim me natyrën, përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe limitet kohore të parashikuara për të përfunduar këtë procedurë.

2.3.4 Operatori ekonomik sipas natyrës se tij **prodhues apo tregetues** (operator prodhues konsiderohen ato operator qe nepermjet procesit te prodhimit transfromojne lendet e para dhe ndihmese ne produkte te gatshme apo montojne pjese te produktit te prodhuara nga subjekte te tjere duke i transformuar ne produkte te gatshem. Operatoror tregetues jane ato operator qe marrin pjese ne blerje-shitje te produkteve te gatshme pa marre pjese ne prodhim) **duhet te kete minimalisht te punesuar punonjes sipas profesioneve me kode respektive apo te peraferta sipas listes se profesioneve miratuar me VKM nr. 514, date 20.9.2017 “Per miratimin e listes kombetare te profesioneve (LKP), te rishikuar”:**

1 (nje) inxhinier druri (shoqerite prodhuese) vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës;
- diplomën, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm.

1 (nje) arkitekt (shoqerite prodhuese dhe tregetuese) vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës;
- diplomën, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm

3 (tre) marangoz/ mobilier/ montues mobiljesh/ përpunues druri vërtetuar me (shoqerite prodhuese dhe tregetuese):

- kontratën individuale të punës;
- diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit ne profesionin respektiv, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;

2 (dy) shofer (shoqerite prodhuese dhe tregetuese) vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës ose me kontraktim.
- leje drejtimi, e vlefshme;

4 (kater) punonjës të thjeshtë (shoqerite prodhuese dhe tregetuese) për veprimtari ndihmëse gjatë procesve të punës vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës;

Shenim: Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/b/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar; Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; Vendimi 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP) të rishikuar” dhe Urdhërit nr.99, datë 25.05.2021 “Për miratimin e katalogut kombëtar të kualifikimeve profesionale”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Punonjësit me specialitet e sipërpërmendura kërkohen në përputhje të plotë me objektin e prokurimit, duke qënë se një pjesë e madhe e artikujve të kërkuara janë mobilje druri ose materiale të tjera MDF, melaminë etj. si dhe kombinime te tyre me konstruksione metalike qe kerkojne saldim, etj, të cilat do të prodhohen/montohen/saldohen/aseblohen e te tjere procese pune sipas përmasave dhe specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë

me funksionet e kërkuara nga Autoriteti. Ngjyra e mobiljeve është një element që nuk është përfshirë në specifikimet teknike, pasi kjo do të përcaktohet nga Autoritet Kontraktore përfituese në momentin e realizimit, e cila do të jetë në varësi të preferencave të këtyre autoriteteve me qëllim përshtatjen e mobiljeve me amjentet ku do të vendosen. Argumentimi për stafin e kualifikuar të kërkuar për realizimin e objektit të prokurimit si më poshtë:

1(nje) inxhinier druri. (per kompanite prodhuese)

- Sigurimi i cilësisë, qëndrueshmërisë dhe plotësimi i standarteve të produkteve: Një inxhinier druri ka aftësitë dhe njohuritë për të analizuar, përzgjedhur dhe trajtuar materialet e drurit, për të siguruar që mobiljet janë të qëndrueshme dhe rezistente në kohë. Ai mund të sigurojë që lëndët e para të përmbushin specifikimet teknike dhe që produkti përfundimtar të jetë i cilësisë së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor. Mobiljet kanë të specifikuar disa standarte, dhe një inxhinier druri ka njohuritë e duhura për t'i zbatuar këto standarte gjatë procesit të prodhimit të tyre. Ai është i kualifikuar për të ndihmuar në përzgjedhjen e konstruksioneve të përshtatshme që sigurojnë stabilitetin, estetikën dhe qëndrueshmërinë e produkteve. Një inxhinier druri mund të mbykqyrë aspekte të sigurisë për produktet përfundimtare, që ato nuk paraqesin rrezik për përdoruesit e tyre. Rëndësia e kërkesës për staf të kualifikuar, për një inxhinier druri, qëndron në garantimin e cilësisë dhe përputhshmërisë së produkteve me specifikimet teknike, për të reduktuar kostot dhe për të ofruar siguri dhe qëndrueshmëri në përdorimin e produkteve nga Autoritet Kontraktore përfituese në këtë procedurë prokurimi.

1(nje) arkitekt. (shoqerite prodhuese dhe tregetuese)

- Sigurimi i cilësisë, qëndrueshmërisë dhe plotësimi i standarteve të produkteve: Një arkitekti ka aftësitë dhe njohuritë për të analizuar, përzgjedhur dhe trajtuar materialet e artikullit të kërkuar për tu prodhuar ose blerë, për të siguruar që mobiljet janë në përputhje me kërkesat materiale, dimensionet, ngjyrat dhe format e kërkuara nga porositesit. Ai mund të sigurojë që lëndët e para të përmbushin specifikimet teknike dhe që produkti përfundimtar të jetë i cilësisë së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Mobiljet kanë të specifikuar disa standarte, dhe një arkitekt ka njohuritë e duhura për t'i zbatuar këto standarte gjatë procesit të prodhimit të tyre. Ai është i kualifikuar për të ndihmuar në përzgjedhjen e konstruksioneve të përshtatshme që sigurojnë stabilitetin, estetikën dhe qëndrueshmërinë e produkteve. Një inxhinier me formim arkitekt mund të mbi dhe kqyrë aspekte të sigurisë për produktet përfundimtare, që ato nuk paraqesin rrezik për përdoruesit e tyre. Rëndësia e kërkesës për staf të kualifikuar, për një inxhinier druri dhe arkitekt, qëndron në garantimin e cilësisë dhe përputhshmërisë së produkteve me specifikimet teknike, për të reduktuar kostot dhe për të ofruar siguri dhe qëndrueshmëri në përdorimin e produkteve nga Autoritet Kontraktore përfituese në këtë procedurë prokurimi.

3(tre) marangoz/ mobilier/ montues mobiljesh/ përpunues druri: (shoqerite prodhuese dhe tregetuese)

Tre marangoz/ mobilier/ montues mobiljesh/ përpunues druri ka njohuritë e duhura në lidhje

me përpuniminin edhe montimin e saktë të pjesëve të mobiljeve. Ai është i aftë të zbatojë me saktësi udhëzimet teknike dhe të sigurojë që çdo pjesë e montuar të jetë në përputhje me specifikimet e kërkuara. Ky specialist ndikon në shmangjen e gabimeve që ndikojnë në cilësinë dhe jetëgjatësinë e mobiljeve, duke ulur riskun e defekteve dhe problemeve gjatë përdorimit. Cilësia, stabiliteti dhe siguria janë thelbësore për mobiljet që përdoren në ambiente publike, pasi montimi i gabuar i tyre mund të rrezikojë punonjësit që do t'i përdorin ato. Gjithashtu siguron që montimi/ asemblimi apo procese të tjera të punës të kryhen në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

Ne cdo rast numri i prefesionisteve është kalkuluar mbi bazën e oreve të punës dotore, javore të punonjësit, oreve javore të punës, llojshmerise dhe numrit të artikujve që duhen kontraktuar, proceseve të punës sipas teknologjise së prodhimit të mobiljeve, vlerës totale të procedurës (fondit limit) si dhe natyrës së ofertuesit.

Ky numër punonjësish është minimale që operatori ekonomik ofertues, jo vetëm prodhues por edhe tregëtues, duhet të kenë për zbatimin e kontratës. Kjo krijon bindjen e Autoritetit kontraktor se operatori ekonomik duke patur një staf të kualifikuar, garanton produkte përfundimtare cilësor, të qëndrueshme dhe jetëgjatë, të punuara në përputhje të plotë me specifikimet teknike dhe me standartet e kërkuara në dokumentet e tenderit.

Këto mallra, në pjesën më të madhe të tyre nuk gjenden lirisht në treg me përmasat dhe specifikimet që kërkohen nga Autoritetet Kontraktore, pra kjo kontratë ka si procese prodhimit ose porositë, e cila bëhet sipas Specifikimeve Teknike tek një prodhues, montimin ose asamblimin e mobiljeve, transportin dhe vendosjen e tyre në ambientet e Autoriteteve Kontraktore përfituese.

Punonjësit e tjerë si shoferi dhe punonjësit e thjeshtë janë të domosdoshëm për transportin dhe punën ndihmëse që do të kryhet përgjatë të gjithë proceseve të zbatimit të kontratës. Duke qënë se mjetet e transportit mund të jenë edhe me qera, përveçse në pronësi, është gjykuar e arsyeshme që shofertët mund të diponohen edhe me kontraktim.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar të paktën 1 (një) punonjës të disponojë certifikate si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", e cila të jetë e leshuar nga shoqëria të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të dorëzojë:
Kontratë pune e vlefshme
Certifikatën përkatëse.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021

“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve/skedës teknike nga prodhuesi është një kërkesë e domosdoshme pasi i jep mundësinë Autoritetit kontraktor verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të kërkuara.

Kërkesa për katalogun /skedës teknike ka disa avantazhe: Besueshmëria e informacionit: Një dokument teknik garanton që informacioni të jetë i saktë dhe i përditësuar. Përputhshmëria me specifikimet teknike: Siguron që produktet e ofruara përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e prokurimit. Parandalimi i mashtrimeve: Redukton rrezikun e mashtrimeve ose të ofrimit të produkteve të falsifikuara.

Për sa më sipër AK krijon siguri dhe garanci se mallrat me të cilët do të furnizohet janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DST. Ky katalog do të shërbejë gjithashtu edhe në procesin e marrjes në dorëzim të pajisjes objekt prokurimi nga Autoritetet Kontraktore përfituese për të kryer krahasueshmërinë e specifikimeve teknike gjatë marrjes në dorëzim të tij.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për transportin e mallrave objekt prokurimit duhet të disponojë, mjetet e mëposhtme:

Mjete	Sasia	Gjendja
Mjet transporti me kapacitet mbajtes min 1.5	2 copë	Pronësi ose me qera

a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme) dhe certifikata e pronësisë së mjetit.

b) Për mjetet e siguruara me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe certifikata e pronësisë së mjetit duhet të shoqërohet me kontratën perkatese të qerave.

Shenim: Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr. 9 (**Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit**). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, sipas parashikimeve të pikës 6, të nenit 26, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe të nenit 41, të pika 5/ç të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Nëpërmjet këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomik të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund ti vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektivit të prokurimit.

Është kërkuar që kapaciteti mbajtës të jetë minimumi 1.5 ton, duke marrë parasysh llojin e mallrave që do të transportohen, peshën dhe përmasat që kanë, sidomos disa prej mobiljeve. Një mjet me kapacitet të tillë siguron që mallrat të transportohen të sigurt dhe pa dëmtime në vendndodhjet e kërkuara.

2.3.7. Operatori ekonomik duhet të deklarojë se zoteron në pronësi ose me qira ambiente prodhimi/magazinimi (nese është prodhues) jo më pak se 1000 m² dhe prodhimi/magazinimi (nese është tregëtar) jo më pak se 500 m²

a) Për ambientet në pronësi duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e objektit sipas legjislacionit

b) Për ambientet me qira/huapërdorje, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton marrjen me qira dhe regjistrimin e objektit në pronësi të qiradhenesit.

Shenim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetedeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afatëve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve/skedës teknike nga prodhuesi është një kërkesë e domosdoshme pasi i jep mundësinë Autoritetit kontraktor si Organ Qëndror Blerës verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të kërkuara.

Kërkesa për katalogun /skedës teknike ka disa avantazhe: Besueshmëria e informacionit: Një dokument teknik garanton që informacioni të jetë i saktë dhe i përditësuar. Përputhshmëria me specifikimet teknike: Siguron që produktet e ofruara përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e prokurimit. Parandalimi i mashtrimeve: Redukton rrezikun e mashtrimeve ose të ofrimit të produkteve të falsifikuara.

Për sa më sipër AK krijon siguri dhe garanci se mallrat me të cilët do të furnizohet janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DST. Ky katalog do të shërbejë gjithashtu edhe në procesin e marrjes në dorëzim të pajisjes objekt prokurimi nga Autoritetet Kontraktore përfituese për të kryer krahasueshmërinë e specifikimeve teknike gjatë marrjes në dorëzim të tij.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogët/ fragmente të katalogut ose skedat teknike për artikujt e listës së kërkuar që përkohet me numrat 3.8.9.10.14.15.16.17.21.28.35.36. Këto dokumente duhet të përmbajë karakteristikat teknike të specifikimeve teknike të kërkuar në dokumentet e tenderit, me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të kërkuara.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve/skedës teknike nga prodhuesi është një kërkesë e domosdoshme pasi i jep mundësinë Autoritetit kontraktor verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të kërkuara.

Kërkesa për katalogun /skedës teknike ka disa avantazhe: Besueshmëria e informacionit: Një dokument teknik garanton që informacioni të jetë i saktë dhe i përditësuar. Përputhshmëria me specifikimet teknike: Siguron që produktet e ofruara përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e prokurimit. Parandalimi i mashtrimeve: Redukton rrezikun e mashtrimeve ose të ofrimit të produkteve të falsifikuara.

Për sa më sipër AK krijon siguri dhe garanci se mallrat me të cilët do të furnizohet janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DST. Ky katalog do të shërbejë gjithashtu edhe në procesin e marrjes në dorëzim të pajisjes objekt prokurimi nga Autoritetet Kontraktore përfituese për të kryer krahasueshmërinë e specifikimeve teknike gjatë marrjes në dorëzim të tij.

2.3.9. Operatori ekonomik/Bashkimi i operatoreve ekonomike sipas artikujve që marrin persiper për furnizim, për artikujt e kërkuar si me poshte duhet të paraqesë dokumentacion të akredituar si “**Certifikate/Certifikate Testimi/Raport testimi**” për produktet:

Karrige statike pa krahe mbështetës (Karrige), produkt i certifikuar në përputhje me standardin SSH EN 1335-1:2020+A1:2022 (SSH EN 1335-1:2021) Mobilje zyre - Karrige pune për zyrë - Pjesa 1: Dimensionet - Përcaktimi i dimensioneve, ose e njëvlefshme dhe e përditësuar, SSH EN 1335-2:2018 (Mobilje për zyrë - Karrige për zyrë - Pjesa 2: Kërkesat e sigurisë) ose e njëvlefshme dhe e përditësuar

- **Tavoline pune (tavoline pune/zyrë)**, produkt i certifikuar në përputhje me standardin SSH EN 527-1:2011 Mobilje zyrash - Tavolinat e punës dhe tryezat - Pjesa 1: Përmasat, ose e njëvlefshme dhe e përditësuar SSH EN 527-2:2016 + A1:2019 Mobilje për zyrë - Tavolina pune - Pjesa 2: Kërkesat e sigurisë, fortësisë dhe qëndrueshmërisë ose e njëvlefshme dhe e përditësuar

- **Karrige klase** produkt i certifikuar në përputhje me standardin SSH EN 1729-1:2015 (EN 1729-1:2015/AC:2016), Mobilje - Karrige dhe tabela për institucionet arsimore - Pjesa 1: Përmasat funksionale, Mobilje - Karrige dhe tabela për institucionet arsimore - Pjesa 1: Përmasat funksionale, EN 1729-2023 Mobilje - Karrige dhe tavolina për institucionet arsimore - Pjesa 2: Kërkesat e sigurisë dhe metodat e provës ose e njëvlefshme dhe e përditësuar

- **Karrige kopshti** produkt i certifikuar në përputhje me standardin SSH EN 1729-1:2015 (EN 1729-1:2015/AC:2016), Mobilje - Karrige dhe tabela për institucionet arsimore - Pjesa 1: Përmasat funksionale, Mobilje - Karrige dhe tabela për institucionet arsimore - Pjesa 1: Përmasat funksionale, EN 1729-2023 Mobilje - Karrige dhe tavolina për institucionet arsimore - Pjesa 2: Kërkesat e sigurisë dhe metodat e provës ose e njëvlefshme dhe e përditësuar

Si dokument alternativ ne vend te “Certifikate/Certifikate testimi/Raport testimi” te produkteve koresponduese e standardeve te mesiperme, operatori ekonomik mund te paraqese Certifikata me reference standarde e mesiperme ose ekuivalente (Certifikata ekuivalente konsiderohet certifikate qe nuk i referohet sistemit europian EN te standardeve, por nje sistemi tjeter standardesh por qe trajton te njejtet tregues dhe norma te testuara dhe konfirmuara te produktit si ne sistemin EN)/te “Perditesuara” sipas standarteve SSH/EN mbi konformitetin e standarteve europiane dhe te leshuara nga Organizma te Vleresimit te Konformitetit te akredituara per leshimin e ketyre dokumentave ne Republiken e Shqiperise ose Organizma Nderkombetare akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise, si dhe dokumenta te tjere alternative si “Certifikate/Deklarate Konformiteti”, “Deklarate CE” “Skeda Teknike”, “Pasaporta Teknologjike” me kusht qe keta dokumenta alternative te jene te shoqeruara me “Certifikatat e testimi/Raportet e Testimit” per secilin produkt me reference standarde e kerkuara si me siper.

Certifikatat e kerkuara duhet te jene te vlefshme ne periudhes se realizimit te procedures se prokurimit. Certifikatat e mesiperme duhet te jene origjinale ose te njehsuara me origjinalin (kopje e noterizuar). Ne rastet kur oferta dorezohet nga nje BOE, operatoret duhet te disponojne dokumentacionin e kerkuar ne perputhje me raportin e pjesemarrjes ne furnizim, te percaktuara ne akt marreveshje.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 79 të LPP, të pikës 1, nenit 44, të VKM–së nr.285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Keto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

Bazuar në natyrën e objektit të prokurimit i cili ka punime dhe mobilim të ambjenteve është parë e arsyeshme kërkesa si më sipër për garantimin e cilësisë së punimeve dhe mallrave objekt prokurimi si dhe bazuar në Ligjin Nr.9870, datë 04.02.2008 Per standartizimin ku qëllimi kryesor i vendosjes së këtij kriteri është të rrisë nivelin e sigurisë së produkteve dhe proceseve, në mbrojtje të shëndetit e jetës së personave, si dhe mjedisin, duke ndihmuar në zbatimin e legjislacionit, në funksion të kërkesave për ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, sigurisë e shëndetit, mbrojtjes së mjedisit dhe konsumatorit, duke siguruar, në këtë mënyrë, rregulla të përbashkëta për të siguruar përdorimin me efektivitet të punës, të materialeve dhe të energjisë.

2.3.10. Operatori ekonomik duhet te deklaroje sipas tabelës 1 nese eshte prodhues ose sipas tabelës 2 nese eshte **tregtues i autorizuar** nga prodhuesi ose **distributor i autorizuar nga prodhues** per mallrat objekt prokurimi.

Tabela 1. Forma e deklarimit per operatorin ekonomik qe paraqitet si prodhues/perpunues i mallit.

Nr.	Emertimi i produktit	Vendi i origjines se mallit
1		
2		

Etj.,		
-------	--	--

Tabela 2. Forma e deklarimit per operatorin ekonomik qe paraqitet si tregtues i autorizuar nga prodhuesi ose distributor i autorizuar nga prodhuesi/perpunuesi.

Nr.	Emertimi i produktit	Vendi i origjines se mallit	Prodhuesi/ Distributori i autorizuar nga prodhuesi/perpunuesi
1			
2			
Etj.,			

Per mallrat objekt prokurimi qe perfshihen ne tabelen 2, OE duhet te paraqese "Autorizim Prodhuesi/Autorizim Distributori/Kontrate furnizimi ose cdo dokument tjeter qe konfirmon lidhjen me furnizuesin apo posedimin e tyre". Dokumentet duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon/fax email, website, kjo e nevojshme per AK ne rast verifikimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar per njohjen origjines se produkteve pasi mbi origjinen e tyre gjykohet nese furnizuesi per realizimin e artikujve qe do te ofroje jep garancite e kerkuara ne kriteret te vecanta te kualifikimit si ne rastin e prodhuesit, por edhe ne rastin e furnizuesit te natyres tregtare, Autoriteti kontraktor ka mundesi qe te verifikojte te dhenat dhe kapacitetin furnizues, cilesor etj te kompanive furnizuese te operatorit ekonomik ofertues te natyres tregtuese.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Ligjin nr.162, 23.12.2020 "Për prokurimin publik" (të ndryshuar) dhe nenit 40, pika 6/ a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", (të ndryshuar). Autoriteti kontraktor ka gjykuar të arsyeshme paraqitjen e mostrave për zërat kryesore te preventivit, duke marrë në konsideratë sasinë e tyre, vlerën e fondit limit, specifikimet që ka artikulli objekt prokurimi. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që të verifikohet përputhshmëria e specifikimeve teknike të kërkuara me ato të paraqitura pranë AK-së.

2.3.11. Operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate me ane te se ciles merr persiper te kryeje sherbimin e transportit, montimit si dhe vendosjen neper vende te te gjitha artikujve ne adresat e percaktuara ne planin e shperndarjes. Per ngjyrat e mobiljeve, duhet te kontaktohet paraprakisht Autoriteti Kontraktor.

2.3.12. Operatori ekonomik duhet të lëshojë një deklaratë për periudhën minimale 1 (nje) vjecare të garancisë së mallrave objekt prokurimi nga data e dorëzimit të mallit, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin e defekteve për shkak të prodhimit dhe montimit.

2.3.13. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës deklaron se artikujt objekt prokurimi do të jenë të reja, të papërdorura më parë dhe pa dëmtime estetike apo në strukturë.

2.3.14. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë miratimi, me anë të së cilës deklarohet se artikujt për të cilët është kërkuar në specifikime teknike plotësimi i standardeve të vecanta i plotësojnë ato dhe merr përsipër dorëzimin e tyre para lidhjes së kontratës nëse shpallet fitues.

Shënim: 1. OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

- Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s’kualifikimi.

2. Referuar nenit 82, pika 4 e ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 për “Prokurimin publik” “Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë”, si dhe Nenit 26, pika 6, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, “Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.”

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë disponibilitet të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës sipas kërkesave të AK. Deklaratat e mësipërme janë kërkuar pasi janë të nevojshme për zbatimin e kontratës me sukses dhe për të siguruar cilësinë e mallrave pasi mund të gjendemi para faktit që këto mallra të jenë të një cilësie të dobët ose të

kenë difekte fabrikimi, ndaj OE duhet të jetë i gatshëm për zëvendësimin e tyre dhe i shërben AK për njohjen e reputacionit dhe besueshmërisë së OE.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP (e ndryshuar), si dhe Nenit 39, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(e ndryshuar), **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të Nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike/termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/specialistët e fushës, anëtar të njësisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Blerje pajisje dhe orendi”**, Njësia e Prokurimit autorizoi personat përgjegjës për prokurim.